REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë,

- Mbështet rolin kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë, për përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe për veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, ku shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet garantohen nga shteti;

- Dëshmon vullnetin e tij për të garantuar pavarësinë dhe paanësinë e veprimtarisë së këtij institucioni, me qëllim përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit të jashtëm;

- Nxit përmbushjen e misionit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, si dhe në përmirësimin e metodologjisë së kontrollit;

- Vlerëson rëndësinë themelore që ka raportimi vjetor në Kuvend për veprimtarinë e institucionit, në përmbushje të detyrimit kushtetues dhe ligjor, si mjet i ushtrimit të funksionit të kontrollit efektiv parlamentar.

Konstaton se gjatë vitit 2013 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka kryer të gjitha auditimet e planifikuara në drejtim të veprimtarisë kontrolluese. Edhe pse rezulton rritje e rekomandimeve të dhëna nga KLSH-ja në drejtim të masave organizative, masave disiplinore, kallëzimeve penale, si dhe përmirësimeve ligjore, mbetet problematikë shkalla e ndjekjes së tyre nga ana e organit rekomandues, me qëllim evidentimin e pritshmërive lidhur me masën e dëmit të shlyer për llogari të Buxhetit të Shtetit.

- Efektshmëria e masave disiplinore dhe administrative të rekomanduara, por dhe shkalla e përmbushjes së tyre nga institucionet përgjegjëse, për vitin 2013 rezulton në nivel mesatar.

- Në raport mungon analiza në lidhje me fenomenin e rritjes së shkallës së pazbatueshmërisë së masave organizative të propozuara nga KLSH-ja. Gjatë vitit 2013 rezulton shifra më e lartë e moszbatimit në 4 vitet e fundit.

- Raporti nuk paraqet të dhëna lidhur me marrjen në konsideratë të propozimeve të rëndësishme për ndryshime, në kuadrin kushtetues dhe ligjor, që KLSH-ja ka adresuar pranë organeve kompetente.

- Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017 përbën një arritje konkrete për veprimtarinë e institucionit, e cila do të ketë impaktin e vet pozitiv si në aspektin e ushtrimit të detyrave funksionale, ashtu edhe në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore.

- Ka rritje të transparencës institucionale të KLSH-së, veçanërisht në komunikimin e drejtpërdrejtë me median, si dhe nëpërmjet publikimeve dhe botimeve zyrtare dhe shkencore.

- Ka intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe me institucionet vendase, të përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike.

- Gjatë vitit 2013 KLSH-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë menaxhimit institucional, duke pasqyruar ecurinë e reformës në zhvillimin e burimeve njerëzore, lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale, të etikës dhe të performancës në tërësi.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2014, kërkon nga KLSH-ja:

1. Angazhim maksimal, në zbatimin e politikave antikorrupsion, në funksion të detyrimeve kushtetuese, ligjore dhe kërkesave të organizmave ndërkombëtarë, rekomandimeve të progres-raporteve të Komisionit Europian, me qëllim mbrojtjen e fondeve shtetërore të taksapaguesve shqiptarë.
2. Ndjekjen rast pas rasti të ecurinë së kallëzimeve penale, duke ridimensionuar komunikimin institucional me organet e drejtësisë dhe me institucionet e hetimit, si dhe kërkimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj fondeve buxhetore për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.
3. Hartimin e programeve të punës për rritjen e efiçencës së veprimtarisë audituese në drejtim të auditimit të performancës, auditimit financiar dhe atij tematik, si dhe rifillimin e punës për auditimin vlerësues.
4. Garantimin e veprimtarisë audituese me cilësi të lartë dhe efektivitet, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit.
5. Konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerët vendas dhe të huaj, me synim përmirësimin e menaxhimit publik dhe financiar të vendit.
6. Vijimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe institucionet ligjzbatuese për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit.
7. Rritjen e numrit të auditimeve të subjekteve me projekte me financim të huaj, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e shpërdorimeve të fondeve publike dhe mungesës të efektivitetit të investimeve.
8. Reformimin e burimeve njerëzore për t'iu përgjigjur nivelit të parametrave të kërkuar nga INTOSAI për arritjen e objektivave integruese të vendit.
9. Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivelet bashkëkohore, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë.
10. Strukturimin e raportit vjetor, në aspektin formal dhe të përmbajtjes, sipas përcaktimeve kushtetuese, ligjore dhe standardeve të aplikueshme nga institucionet

homologe të auditit të jashtëm.

Kuvendi i Shqipërisë angazhohet që:

Në ushtrim të funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë mbështet ndërveprimin gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve ligjzbatuese, lidhur me detyrueshmërinë e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 26.6.2014